



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 12.11.2012, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Kimete Bytyçi, Albana Gashi, Justina Pula, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi - zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Nevahir Hazeri-KDI; Ukë Gashi-ZPRK; Elita Vokshi, Lejla Selimi-OSBE, Florije Kryeziu-UNICEF, Visar Bivolaku- EU OFFICE-EURS dhe Nuredin Ibishi-CDF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdaliu- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 tetor 2012;
3. Njoftim nga grupet punuese lidhur me monitorimin e Ligjeve;
4. Të ndryshme.

Kryetarja - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 tetor 2012,

Kurtan Kajtazi- Tha se në fjalinë ku flitet për trajnimin e Komisionit me pjesëmarrje të ABGJ- së dhe OSBE-së, fjalisë i ka humbur kuptimi dhe kërkoj që të rregullohet kjo fjali.

Pas përgjigjes nga administrata e Komisionit se kuptimi i fjalisë paksa ndryshuar, pasi që procesverbali është lekturuar dhe se fjalia do të përmirësohet me vërejtjen e dhënë.

Kryetarja- Tha se ka hasur lëshime sa i përket përkthimit në gjuhën serbe dhe se është mirë përkthyesit të kenë kujdes në lidhje të fjalive dhe në emërime të institucioneve. Ajo kërkoj që të bëhet një përkthim me profesional.

Komisioni miratoi procesverbalin e dt. 29.10.2012 me vërejtjen e deputetit Kurtan Kajtazi dhe sugjerimet e dhëna nga kryetarja e Komisionit.

3. Njoftim nga grupet punuese lidhur me monitorimin e Ligjeve

Kryetarja- Lidhur me monitorimet e Ligjeve tha se Komisioni është duke bërë monitorimin e tri Ligjeve, kemi formuar për secilin ligj, nga një grup punues, është duke u bërë monitorimi i Ligjit për barazi gjinore, Ligjit kundër diskriminimit dhe Ligjit për Avokatin e Popullit. Ajo tha se punët e shumta rreth këtyre monitorimeve kanë përfunduar dhe në konsultim me anëtarët e grupeve punuese, kam marrë informata se me siguri deri më 15 dhjetor do të jenë të gatshme raportet lidhur me këto monitorime të këtyre ligjeve.

Ajo shtoi se sa i përket monitorimit të Ligjit për barazi gjinore, është përfunduar draftimi i parë i raportit, por kemi pasur pyetje se sa është pjesëmarrja e femrës në vendimmarrje, atëherë i kemi zgjeruar pyetësorët dhe i kemi dërguar nëpër institucione, disa institucione, si partitë politike, nuk kanë ofruar përgjigjeje ende. Nga përgjigjet që kemi marrë nga ministratë situata nuk qëndron keq, por në komuna nuk është situatë e mirë e nivelit të pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së femrave.

Sa i përket Ligjit kundër diskriminimit, është paksa më vështirë të bëhet monitorimi, është vështirë të identifikohen se cilat të drejta të ky ligj nuk respektohen, apo në çfarë aspekti është diskriminuar personi i caktuar? Ajo tha se edhe për këtë Ligj kemi dërguar pyetësor nëpër komuna, nga disa kemi marrë përgjigjeje, e nga disa të tjera jemi në pritje. Të gjitha të dhënat do të finalizohen dhe raporti do të jetë i gatshëm për muajin dhjetor.

Rita Hajzeraj, kryesuese e grupit punues për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit- Tha se edhe punët rreth monitorimit të këtij Ligji janë duke u finalizuar, është bërë një punë shumë e mirë. Grupi ka pasur disa vizita në terren, sa i përket moszbatimit të këtij ligji ne i kemi parasysh mangësitë dhe arsyet e moszbatimit të Ligjit, për këtë janë përgjegjëse edhe disa Institucione përgjegjëse, edhe për këtë Ligj kanë munguar udhëzimet administrative.

Ajo tha se edhe raporti për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit do të jetë i gatshëm shumë shpejt.

4. Të ndryshme

Kimete Bytyçi- I njoftoi anëtarët e Komisionit me agjendën rreth vizitave në terren dhe datat se kur mund të bëhen këto vizita, që do t'i ketë grupi punues për të drejtat e fëmijëve.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur rreth këtyre vizitave, tha se duhet parë mundësin e vizitave edhe nëpër qendra të tjera që merren me të drejtat e fëmijëve, sepse datat janë diçka që mund të ndryshohen dhe të përshtaten.

Kymete Bajraktari- Tha se më herët Ministria e Punëve të Brendshme e ka dërguar një raport lidhur me të drejtat e fëmijëve. Ajo e ka ngritur shqetësimin lidhur me trafikimin e fëmijëve. Unë edhe atëherë kam ngritur shqetësimin që të na vijë një raport me i detajizuar se si është gjendja, përveç raportit për trafikimin e fëmijëve kisha kërkuar të na dërgohet një raport për trafikimin e qenieve njerëzore dhe duke vënë në pah respektivisht trafikimin e fëmijëve në Kosovë, dhe në raport të ceket aktiviteti se çka është ndërmarrë për parandalimin e këtij fenomeni.

Kryetarja- Lidhur me këtë kërkesë të parashtruar nga deputetja tha se kësaj kërkesës është mirë me ju bashkangjitur edhe kërkesa për regjistrimin civil të fëmijëve në Kosovë, sepse sipas një raporti të fundit të UNICEF- it figuron se 8.3% e fëmijëve në Kosovë janë të paregjistruar, dhe për këto është mirë që të dyja këto kërkesa me i përfshirë në një kërkesë të vetme në emër të Komisionit për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kurtan Kajtazi- Tha se është shokuese se çka është diskutuar në atë Konferencë. Ato shifra nuk janë te sakta, sepse të gjithë e dimë se si shkon procedura e regjistrimi, mund të ketë raste të mos regjistrimit të fëmijëve, por jo edhe shifra marramendëse.

Kryetarja- Tha se për arsye të saktësimit ne po kërkojmë raport nga Ministria, dhe se këto janë kërkesa me vend.

Përfundim

Komisioni në mënyrë unanime vendosi që të bëjë kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të dërgojë raport para Komisionit lidhur me situatën e Trafikimit të qenieve njerëzore dhe fëmijëve, në veçanti dhe masat që ka ndërmarrë për parandalimin e këtij fenomeni, si dhe për regjistrimin civil të fëmijëve në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu

